



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

NJOFTIM PËR SHPREHJE INTERESI PËR TRAJNERË PËR DHËNIE TRAJNIMI
PËR ADMINISTRATËN ZGJEDHORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkon të kontraktojë trajnerë, në rang vendi, për dhënie trajnimi për administratën zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021:

54 trajnerë për dhënie trajnimi për anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ);

265 trajnerë për dhënie trajnimi për anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV-ve);

92 trajnerë për dhënie trajnimi për anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV-ve).

Përshkrimi i detyrave kryesore të trajnerit:

- ✓ Rol aktiv në udhëheqjen dhe menaxhimin efikas të organizimit dhe zhvillimit të trajnimit;
- ✓ Praktikoni metoda të trajnimit që sigurojnë përfshirjen aktive të gjithë pjesëmarrësve në trajnim;
- ✓ Aftësi për të udhëhequr diskutimet duke ruajtur klimën pozitive;
- ✓ Ofroni udhëzime të qarta në procedurat dhe aktivitetet gjatë seancave të trajnimit, për arritjen e rezultateve të moduleve të trajnimit;
- ✓ Përdorimi i TIK për të vizualizuar përmbajtjen e moduleve;
- ✓ Dokumentoni dhe raportoni për zhvillimin e trajnimit, sipas kërkesave të KQZ-së.

Kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët:

1. Diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura” apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
2. Përvojë pune, 3-5 vite, në fushën e së drejtës, administratën publike, mësimdhënie, OJF që kanë objekt të veprimtarisë së tyre rritjen e kapaciteteve përmes zhvillimit të trajnimeve, si dhe çdo përvojë pune e barasvlefshme me to;
3. Pesë vitet e fundit të mos ketë qënë i zgjedhur në organet drejtuese qendrore dhe vendore të partive politike dhe të mos ketë patur aktivitet të deklaruar publik në fushatë zgjedhore ose aktivitetin politik të një subjekti zgjedhor;
4. Të mos jetë në detyrë në strukturat e organeve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, inspektoriatit qendror apo lokal, ushtarak aktiv i Forcave të Armatosura, punonjës i Shërbimit Informativ;



5. Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
6. Të mos jetë i dënuar administrativisht për shkelje të dispozitave, të cilat lidhen me zgjedhjet, apo të mos ketë masë disiplinore në fuqi në shërbimin civil;
7. Të ketë aftësi komunikimi, menaxhimi dhe raportimi, të përdorë lehtësisht programet bazë kompjuterike.

Aplikimi:

Dokumentacioni:

1. Kërkesë e nënshkruar për shprehje interesi si dhënës të trajnimit në qarkun/bashkinë përkatëse, duke përcaktuar nivelin KZAZ, KQV, GNV;
2. Kopje të dokumentit të identifikimit (kartë identiteti/pasaportë);
3. Jetëshkrim (CV), ku të pasqyrohet adresa e postës elektronike dhe numri telefonik i kontaktit;
4. Diplomë e arsimit të lartë (e noterizuar);
5. Kopje e librezës së punës (e noterizuar);
6. Certifikatë personale të lëshuar nga zyra e gjendjes civile apo nga portali e-albania;
7. Certifikatë kualifikimi, trajnimi ose dokument tjetër, që vërteton eksperiencën si trajnerë (nëse ka);
8. Deklaratë e nënshkruar për përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes, pikat 3, 4, 5, 6.

Shprehja e interesit për dhënie trajnimi mund të jetë për një, dy apo të tre nivelet e trajnimit.

Dorëzimi i dokumentacionit:

Afati:

3 Shkurt 2021, për të interesuarit që do të aplikojnë për dhënie trajnimi për KZAZ-të;
10 Shkurt 2021, për të interesuarit që do të aplikojnë për dhënie trajnimi për KQV-të;
17 Shkurt 2021, për të interesuarit që do të aplikojnë për dhënie trajnimi për GNV-të.

Adresa: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rruga “Ibrahim Rugova” nr. 4”, Tiranë.